



Teach For Kosova dhe Universiteti i Prizrenit Ukshin Hoti, nënshkruan këtë:

### MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Me datën 4 Nëntor 2020, Teach For Kosova në takim me Udhëheqësin e Zyrës për Zhvillim të Karrierës, u pajtuan të bashkëpunojnë rreth zbatimit të aktiviteteve të Teach For Kosova; organizimit të info-sesioneve me studentë për procesin e rekrutimit në programin e saj, organizimi i fokus grupeve me student, dhe ofrimin e trajnimeve të përshtatura për nevojat e studentëve të Universiteti i Prizrenit Ukshin Hoti, duke filluar nga Nëntori 2020.

Me anë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Teach For Kosova zotohet që brenda një periudhe 2 vjeçare:

1. Do të përgatisë dhe organizoj së paku një sesion informues në vit për studentët e Universitetit të Prizrenit Ukshin Hoti për të i informuar mbi thirrjen për aplikim në programin e fellowship-it të Teach For Kosova;
2. Do të organizoj së paku një fokus-grup me studentë të Universitetit të Prizrenit Ukshin Hoti për të mbledhur informata mbi vështirësitë e tyre në përcaktimet për karrierë, si dhe për qëllime të organizatës në definimin e profilit të mësimdhënësit-lider ideal;
3. Teach For Kosova do të trajnojë një grup të studentëve ekzistues apo alumni të përzgjedhur nga Universiteti i Prizrenit Ukshin Hoti në aftësi të buta, zhvillim të debateve, dhe aftësive të tjera të ngjashme së paku një herë në semestër;

Ndërsa, Universiteti i Prizrenit Ukshin Hoti zotohet se:

1. Asiston në organizimin e sesioneve informuese për Teach For Kosova me studentët e Universitetit, së paku një herë në vit duke i paraprirë hapjes së thirrjes për aplikim në programin e fellowship-it të Teach For Kosova;
2. Asiston në organizimin e së paku një fokus-grupi me studentë të Universitetit të Prizrenit për të mbledhur informata mbi vështirësitë e tyre në përcaktimet për karrierë, si dhe për qëllime të organizatës në definimin e profilit të mësimdhënësit-lider ideal;
3. Definojnë nevojat për trajnime për studentë dhe alumni të Universitetit, të cilat pastaj përgatiten dhe realizohen nga Teach For Kosova – së paku një herë në semestër;
4. Ndihmon dhe lehtëson takimet dhe aktivitetet e stafit të Teach For Kosova me palët e interesit siç janë: zyrtarët e universitetit, studentët dhe alumni, zyrën për zhvillim të karrierës;

Përmes këtij Memorandum Mirëkuptimi, Universiteti i Prizrenit Ukshin Hoti dhe Teach for Kosova pranojnë njëri-tjetrin si partnerë zhvillimor në fushën e arsimit, dhe inkurajojnë të gjitha palët e interesuara që gjithashtu të mbështesin programin dhe aktivitetet e lartëshënuara. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në momentin kur nënshkruhet nga të dy palët, dhe vlenë për periudhën e implementimit të projektit.



Në emër të Teach For Kosova:  
Egzon GASHI, Drejtor Ekzekutiv



Në emër të Universitetit të Prizrenit Ukshin Hoti:  
prof. dr. Ismet Temaj, Rektor

për 

